



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:009056
Datë: 30.03.2023
Numri i dokumentit: 04139730

E.nr.982/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditorëve: Z.I., V.H. dhe S .Q. të cilët i përfaqëson av Abdurrahim Islami nga Ferizaj, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 29.03.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.982/22**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorëve.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.982/22, të datës 29.07.2022, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2022:009056, të datës 02.02.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 12.01.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,078.00 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorëve.

Meqenëse kreditorët e kanë realizuar kërkesën e tyre, Gjykata konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.982/22, më datë 29.03.2023

GJYQTARI
Faton Ajvazi